

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë



Programi Y i përmbledhjes së politikave ofron informacione bazë mbi aspektet kyçe të zhvillimit, zbatimit dhe integritit të kurikulës arsimore të bazuar në shkencë të Programit Y në arsimin formal në Ballkan.

Programi Y është një kurrikulë arsimore e bazuar në dëshmi që kontribuon në zhvillimin e njohurive funksionale, qëndrimeve dhe aftësive psiko-sociale të të rinjve, që janë një predispozitë¹ e rëndësishme për rritjen e tyre të shëndetshme dhe më të sigurt. Bazuar në metodat moderne pedagogjike të punës, të cilat përfshijnë të nxënit bashkëpunues dhe pjesëmarrës, Programi Y përgatit të rinjtë të njohin dhe kuptojnë rreziqet, të mendojnë në mënyrë kritike për pasojat dhe i përgatit ata të marrin vendime që janë në interesin më të mirë të shëndetit të tyre dhe shëndetin e bashkëmoshatarëve të tyre.

TRE PARIME TË CILAT DUHET TË MBAHEN MEND

- 1. Adolehentët janë një popullatë në përgjithësi e shëndetshme,** por shprehitë e tyre jetësore, individualisht ose kolektivisht, janë faktor kyç në shfaqjen ose parandalimin e sëmundjeve kronike në moshën madhore.
- 2. Edukimi i bazuar në shkathtësitë jetësore** kontribuon në zhvillimin e kapacitetit të të rinjve për të marrë vendime që janë në interesin më të mirë të ruajtjes së shëndetit të tyre.
- 3. Programi Y dhe Klubi Bëhu Burrë** janë programe të bazuara shkencërisht dhe programe të efektshme arsimore të dëshmuara të bazuara në zhvillimin e shkathtësive jetësore të nxënësve të shkollave të mesme.

1 — Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2003). Aftësitë për shëndetin: edukim shëndetësor i bazuar në shkathtësi, përfshirë shkathtësitë jetësore: një përbërës i rëndësishëm i një shkolle miqësore për fëmijë/promovuese e shëndetit. Organizata Botërore e Shëndetësisë. <https://apps.who.int/iris/handle/10665/42818>

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Iniciativa e Burrave të Rinj

- një platformë rajonale për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e edukimit shëndetësor

Iniciativa e Burrave të Rinj - YMI është program regjional i organizatës CARE International Balkans me një vazhdimësi qysh nga viti 2006 i cili përfshin ministritë e arsimit, institutet pedagogjike, shkollat, nxënësit, prindërit dhe OJQ-të në një partneritet dhe proces proaktiv të zhvillimit, testimit dhe përmirësimit të programeve arsimore, për të krijuar mundësi më të mira arsimore dhe shëndetësore për të rinjtë. Programi është duke u zbatuar me sukses në Serbi, Kroaci, Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë (BeH), Shqipëri dhe pjesërisht në Mal të Zi². Iniciativa e Burrave të Rinj është një platformë për një bashkëpunim dhe zhvillim ndërinstitucional, me fokus të veçantë në krijimin e programeve të qëndrueshme që janë të rëndësishme për zhvillimin e popullatës dhe rritjen e edukimit shëndetësor³ të të rinjve në Ballkan. Me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të institucioneve arsimore, OJQ-ve, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë brenda Iniciativës së Burrave të Rinj, u krijuan Programi Y dhe programi plotësues (mbështetës) Klubi Bëhu Burrë, të cilat në mënyrë sinergjike kanë një ndikim edhe më të fortë në perceptimin e të rinjve për rëndësinë e kujdesit shëndetësor dhe aftësinë e tyre për të marrë vendime të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit, e cila është konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga hulumtimi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Projekti YMI dhe Programi i tij më i rëndësishëm arsimor Y janë treguar efektivë në zvogëlimin e dhunës, eliminimin e faktorëve të dëmshëm shoqërorë, rritjen e nivelit të barazisë gjinore dhe zhvillimin e shprehive të shëndetshme të jetës së adoleshentëve në kontekste të ndryshme politike, institucionale, kulturore dhe kombëtare të vendeve të Ballkanit.

2 – Një Program i modifikuar Y i quajtur Programi Kiwi po zbatohet në Gjermani me synimin për të lehtësuar integrimin e emigrantëve nga Azia dhe Afrika në shoqërinë gjermane. Gjeni më shumë informacion në <https://www.care.de/care-hilfe/bildung-in-deutschland/integrationsprojekt-kiwi>

3 – Organizata Botërore e Shëndetësisë. Zyra Rajonale për Evropë. (2013) Njohuritë shëndetësore: faktet e qëndrueshme. <https://apps.who.int/iris/handle/10665/326432>

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Normat sociale, adoleshenca dhe edukimi

Socializimi, ndërveprimet me bashkëmoshatarët dhe mjedisi në thelb ndikojnë në qëndrimet dhe vendimet e të rinjve kur bëhet fjalë për shëndetin dhe mënyrat e shëndetshme të jetesës. Kjo është arsyeja pse sistemet moderne të edukimit i kushtojnë vëmendje të veçantë të të mësuarit e të rinjve të shoqërohen në një mënyrë që është në interesin më të mirë të shëndetit të tyre.

Ndjeshmëria ndaj ndikimeve shoqërore është individuale dhe specifike, kështu që programet arsimore që i vendosin nxënësit në qendër të të mësuarit kanë potencialin për t'iu përgjigjur nevojave individuale, shumë më përpara qasjeve tradicionale që dërgojnë një mesazh me një drejtim për të gjithë nxënësit si një grup homogjen.

Normat shoqërore, me një theks të veçantë në normat gjinore dhe stereotipet gjinore, mund të inkurajojnë të rinjtë të sillen në mënyrën të cilën institucionet arsimore dhe shëndetësore duan të parandalojnë, por gjithashtu të dekurajojnë të rinjtë nga përdorimi i shërbimeve që mund të jenë të rëndësishme për ta në ruajtjen e shëndetit. Djemtë mund të mendojnë se të kërkuarit e ndihmës është një shenjë e dobësisë, ndërsa vajzat që cigarja e parë dëshmon se janë të pjekura, se dhuna ndaj të tjerëve është e justifikuar, se në rast të ekspozimit ndaj dhunës ata duhet të gjejnë një zgjidhje vetë, pa ndërhyrë me autoritet. Sjelljet, qëndrimet dhe vlerat e djemve dhe vajzave ndryshojnë dhe ndikohen nga normat gjinore, ashtu që qasja e ndjeshme ndaj gjinisë kërkon të përgjigjet në përputhje me ndryshimet ekzistuese, por me të njëjtin qëllim, duke krijuar mundësi shtesë për djemtë dhe vajzat për të jetuar një jetë më të mirë dhe më të shëndetshme.

Duke ndryshuar paradigmen e edukimit shëndetësor, është e mundur të ndikoni në krijimin e një gjenerate të re të të rinjve që besojnë në korrektësinë e vendimeve që janë në interesin më të mirë të shëndetit të tyre.

Nevojat dhe problemet e të rinjve

Probleme të shumta shëndetësore (sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, kanceri, çrregullimet e shëndetit mendor, infeksionet seksualisht të transmetueshme) që disa të rinj do të përjetojnë në moshën e rritur, kanë zanafillën e zhvillimit në adoleshencë⁴. Adoleshentët janë një popullatë përgjithësisht e shëndetshme, por shprehitë e tyre jetësore, individualisht ose kolektivisht, janë një faktor kyç në shfaqjen ose parandalimin e sëmundjeve kronike në moshën e rritur.

4 — Bundy, D.A.P., N. de Silva, S. Horton, D.T. Jamison, dhe G.C. Patton, redaktorë. Vëllimi 8. (2017). Shëndeti dhe zhvillimi i fëmijëve dhe adoleshentëve. Prioritetet e Kontrollit të Sëmundjeve (botimi i tretë). Banka Botërore. Uashington DC

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Hulumtimet e kryera në BeH, Kroaci, Serbi, Kosovë dhe Shqipëri tregojnë se të rinjtë përballen me një numër sfidash duke u rritur^{5 6 7}: dhuna nga bashkëmoshatarët (dhuna verbale, dixhitale dhe fizike), stresi i lidhur me edukimin⁸, ndikimet negative të bashkëmoshatarëve, përdorimi i duhanit, alkoolit, drogës, shëndeti i dëmtuar mendor, shprehitë jo të shëndetshme të të ushqyerit, aktiviteti i pamjaftueshëm fizik, marrëdhënie të hershme seksuale dhe sjellje të rrezikshme seksuale.

Hulumtimet dëshmojnë një lidhje të drejtpërdrejtë midis normave gjinore dhe shoqërore dhe sjelljeve jo të shëndetshme, pasi që ato inkurajojnë ndjeshmërinë e të rinjve ndaj ndikimeve negative të moshatarëve dhe kontribuojnë në një nivel më të ulët të kërkimit të ndihmës kur ajo është e nevojshme. Nga ana tjetër, normat gjinore mund dhe shpesh zvogëlojnë perceptimin e dhunës si një formë e dëmshme e sjelljes, dhe në këtë periudhë të ndjeshme ato mund të ndikojnë në qëndrimet e të rinjve, pasi që ata duhet të merren me dhunën të cilës i ekspozohen, sepse të kërkuarit e ndihmës shpesh është shenjë e dobësisë në sytë e të rinjve.

Për shkak të të gjitha atyre të cekura më lart, programet arsimore, përveç informacionit mbi shëndetin dhe rëndësinë e mënyrave të shëndetshme të jetës, duhet t'u mundësojnë të rinjve të kuptojnë informacionin e disponueshëm, të zhvillojnë një shkallë më të lartë të vetëbesimit në marrjen e vendimeve që mund të ndryshojnë nga "e pritshme shoqërore", dhe veçanërisht burim i rëndësishëm në këtë kontekst janë shkathtësitë e jetës. Duke zhvilluar mendim kritik, duke zhvilluar ndjeshmëri, duke adoptuar aftësi ndërpersonale të komunikimit, aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe aftësi vendimmarrëse, të rinjtë do të fitojnë kompetencat e nevo-

5 – CARE International Balkans. (2016). Djemtë dhe burrat si aleatë në parandalimin e dhunës dhe transformimin gjinor në Ballkanin Perëndimor - Nisma për të Rinj, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë, Shqipëri.

6 – CARE International Balkans. (2017). Promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës mes të rinjve në Bosnjë dhe Hercegovinë duke sfiduar stereotipat gjinorë, Bosnjë dhe Hercegovinë. <https://careevaluations.org/evaluation/promoting-healthier-lifestyles-among-youth-in-bosnia-and-herzegovina-by-challenging-gender-stereotypes-ii-young-men-initiative-project-ii-yimi-ii/>

7 – CARE International Balkans. (2020). Burrat dhe djemtë si partnerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e ekstremizmit dhe dhunës së të rinjve në Ballkan, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë, Shqipëri. <http://www.careevaluations.org/wp-content/uploads/ENDLINE-REPORT-REGIONAL-YMI-II-FINAL.pdf>

8 – Fondacioni Friedrich Ebert. (2019) Hulumtimi i të rinjve në Kroaci 2018/2019. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kroatien/15291.pdf>

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

jshme për t'u përballur në mënyrë më efektive me ndikimet sociale që ekzistojnë në mjedisin e tyre dhe këto parime janë të integruara në fushën e veprimit të aktivitetit të Programit CARE për Iniciativën për të Rinj brenda të cilit u krijuan programet kurrikulare Programi Y dhe Klubi Bëhu Burrë.

Program me kredibilitet rajonal dhe ndërkombëtar

2010 · Fushata më e mirë për ndryshimin e normave shoqërore – Shoqata Serbe e Marrëdhënieve me Publikun

2016 · Çmimi i I-rë i paqes Ron Kovic në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit "My Hero" për filmin: "Post-War Machismo: Be a Man"

2017 · Fituesi i Çmimit të Inovacionit – Rrjeti Global i Edukimit në Evropë

Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe OJQ-të në 14 vitet e fundit, me pjesëmarrjen e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, i ka mundësuar organizatës CARE dhe organizatave partnere të testojnë dhe të përmirësojnë më tej programin në faza të ndryshme të zhvillimit, i cili përfundimisht është përshtatur me arsimin formal në Ballkan.

Duke analizuar efektivitetin dhe ndikimin e Programit Y tek të rinjtë, ekzistojnë prova të qarta se Programi Y i fuqizon të rinjtë të kundërshtojnë në mënyrë efektive ndikimet e dëmshme të bashkëmoshatarëve, të ndryshojnë qëndrimet rreth dhunës dhe shëndetit, në një mënyrë që afirmon praktikën e mënyrave të shëndetshme të jetesës. Vlerësimet konfirmuan që pjesëmarrja e të rinjve në Klubin Bëhu Burrë ka një ndikim edhe më të madh mbi ta dhe jetën e tyre dhe se të rinjtë që kanë marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e Klubit Bëhu Burrë jo vetëm që bëhen praktikues të mënyrave të shëndetshme të jetës, por bëhen edhe pjesëmarrës aktivë në mobilizimin e bashkëmoshatarëve të tyre në mënyrë që edhe ata të miratojnë qëndrime dhe sjellje që janë në interesin më të mirë të shëndetit të tyre.

Pse është i rëndësishëm përkushtimi ndaj aftësive psiko-sociale?

Përpyekjet globale nga institucionet ndërkombëtare të shëndetësisë dhe arsimit kanë analizuar dhe identifikuar qasjet e reja në arsim, bazuar në zhvillimin e aftësive që u mundësojnë të rinjve të kuptojnë informacionin e marrë në një mënyrë që i motivon ata ta zbatojnë atë në jetën reale. Përveç informacionit tradicional dhe ofrimit të njohurive funksionale, të rinjtë kanë nevojë për aftësitë e mëposhtme:

- Aftësitë e vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësitë e të menduarit kreativ dhe të të menduarit kritik.
- Aftësitë komunikuese dhe ndërpersonale.
- Vetë-ndërgjegjësim dhe ndjeshmëria.
- Ballafaqimi me emocionet dhe ballafaqimi me stresin.

Këto aftësi janë të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor të të rinjve, dhe i vetmi vend ku të rinjtë mund t'i zhvillojnë ato janë institucionet dhe organizatat për arsim formal dhe joformal. Futja e arsimit bazuar në zhvillimin e shkathtësive të jetës në sistemin zyrtar të arsimit u mundëson shteteve zgjidhje të qëndrueshme që kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të popullsisë dhe eliminimin e faktorëve individualë të cenueshmërisë së të rinjve në një mjedis të sigurt dhe kulturor të pranueshëm institucional. Probleme të tilla si dhuna kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën akademike¹ dhe motivimin e të rinjve për të vendosur qëllime më të larta akademike, që përfundimisht mund të ketë një ndikim negativ në mundësitë e përgjithshme ekonomike. Mënyrat jo të shëndetshme të jetesës të tilla si përdorimi i alkoolit, produkteve të duhanit dhe drogës janë një faktor i rëndësishëm në shfaqjen e sëmundjeve jo-ngjithëse dhe varësive, të cilat mund të çojnë drejt sëmundjeve kronike që prekin individët, familjet e tyre dhe komunitetet, si dhe ngarkojnë sistemin e kujdesit shëndetësor. Prandaj, shumë vende përplojnë të prezantojnë programe efektive parandaluese të bazuara në zhvillimin e shkathtësive të jetesës si pjesë e parandalimit primar.

9 — Organizata Botërore e Shëndetësisë Gjenevë. Departamenti i Shëndetit Mendor. (1999). Partnerë në Edukimin e Shkathtësive të Jetës, Konkluzione nga një Takim Ndërmjet Agjencive të Kombeve të Bashkuara https://www.who.int/mental_health/media/en/30.pdf

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Programi Y - Mënyrat e të nxënësve dhe të mësimit në bazë të provave

Programi Y është një kurrikulë gjithëpërfshirëse katërvjeçare që vendosë nxënësit e shkollave të mesme (mosha 15 deri 19 vjeç) në qendër të procesit edukativ. Në shkollë, edukatorët e trajnuar për bashkëmoshatarë së bashku me mësuesit mbajnë seanca të cilat janë të integruara në orarin e rregullt të orëve mësimore të mësimëve në klasë gjatë vitit shkollor, me theks në pesë fusha kyçe të programit:

- (1) barazia gjinore;
- (2) jo dhuna;
- (3) shëndeti seksual dhe riprodhues;
- (4) parandalimi i përdorimit të alkoolit dhe drogës dhe
- (5) prindërimi i përgjegjshëm.

Duke zbatuar stile të ndryshme të mësimnxënies dhe mësimdhënies aktive, kjo përfshin studentët në kërkime, diskutime dhe veprimtari për zgjidhjen e problemeve në të cilët mund të hasin ose që hasin gjatë rritjes. Baza pjesëmarrëse e Programit Y u ofron të rinjve mundësinë për të diskutuar për çështje të ndryshme sociale dhe të rritjes nga këndvështrimi i ndjenjave, qëndrimeve dhe vlerave të tyre dhe kështu të fitojnë njohuri dhe aftësi të reja funksionale që janë një faktor kyç në zhvillimin e individëve të shëndetshëm të cilët kanë kapacitet për t'u marrë me efektivitet me sfidat e jetës së përditshme. Më shumë se 100,000 të rinj kanë fituar njohuri dhe aftësi të reja përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në punëtoritë e organizuara në bashkëpunim me 131 shkollë të mesme në Serbi, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri në 5 vitet e fundit.

Në sajë të zhvillimit dhe testimit për më shumë se dhjetë vjet, programi është përshtatur për të punuar në shkollat e mesme të të gjitha specializimeve, dhe mund të zbatohet nga mësuesit, pedagogët dhe edukatorët e trajnuar mirë. Më shumë se 1600 mësues kanë adoptuar kompetencat e nevojshme për të zbatuar një model gjithëpërfshirës dhe shkencërisht të bazuar për zhvillimin e aftësive psiko-sociale të të rinjve bazuar në modelin Model Y në 5 vitet e fundit.

Klubi Bëhu burrë dhe fushatat shtesë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i programit YMI është fushata "Be a Man" (Shq. Bëhu Burrë), e cila synon të forcojë mesazhet kryesore të Iniciativës së Burrave të Rinj dhe të inkurajojë ndryshimet në nivelin e shkollës dhe të komunitetit. Kjo fushatë shoqërohet nga një larmi e materialeve edukative, mediave sociale dhe aktiviteteve të organizuara dhe të kryera nga nxënësit, anëtarë të Klubeve "Be a Man" (BMC).

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Gjatë adoleshencës, bashkëmohatarët kanë një vend qendror në zhvillimin shoqëror, njohës dhe emocional të të rinjve. Në bashkëveprim me bashkëmohatarët, i riu vë në dyshim dhe zhvillon individualitetin dhe identitetin e tij, dhe ndjenjat e përkatësisë dhe pranimit nga grupi i bashkëmohatarëve dhe ka potencialin për të kontribuar pozitivisht në procesin e përgjithshëm.

Klubet Bëhu Burrë janë një plotësim i procesit arsimor bazuar në zbatimin e metodologjisë së Programit Y. Ngjashëm me sektorët e shkollës, përmes aktiviteteve të synuara dhe afirmimit të pjesëmarrjes së të rinjve në Klubet Bëhu Burrë, të rinjtë kanë më shumë mundësi për të praktikuar aftësi, qëndrime pozitive, vlera dhe sjellje në një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ata mbështeten në refuzimin e shprehive të rrezikshme, me mbështetjen e bashkëmohatarëve të cilët janë anëtarë të të njëjtit klub. Duke aplikuar teknikën e presionit pozitiv të bashkëmohatarëve, të rinjtë adoptojnë më lehtë mënyra të shëndetshme të jetesës dhe refuzojnë shprehi dhe qëndrime të rrezikshme dhe potencialisht të dëmshme. Brenda Klubeve Bëhu burrë, të rinjtë në shkolla dhe komunitetet lokale organizojnë fushata bazuar në pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në hartim dhe zbatim. Hulumtimet tregojnë se të rinjtë të cilët marrin pjesë në aktivitetet e Klubit Bëhu Burrë dhe zbatimin e aktiviteteve të fushatës, në mënyrë më të lehtë dhe efektive miratojnë qëndrime dhe vlera pozitive dhe ndikimi në sjelljen e tyre është më i madh se në rastin e të rinjve që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive. Fushata **Reagoni Njerëzisht** e afirmon rolin e të rinjve në ndalimin e dhunës dëshmitar të së cilës janë dhe në dekurajimin e bashkëmohatarëve nga sjelljet e rrezikshme. Fushatat **A je mirë?** kontribuon në sjelljen pro sociale të të rinjve për të mbështetur shëndetin mendor të bashkëmohatarëve të tyre.



Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Klubet Bëhu Burrë janë krijuar për t'u ofruar të rinjve një hapësirë të sigurt dhe pohuese në të cilën, të udhëhequr nga anëtarë me përvojë, mësues dhe moderatorë, ata miratojnë qëndrime dhe vlera pozitive dhe krijojnë miqësi të shëndetshme brenda klubeve, që është një burim i rëndësishëm social dhe zhvillimor në dispozicion të tyre brenda klubit. Klubet Bëhu Burrë, pavarësisht nga emri, janë krijuar për t'u ofruar mundësi të barabarta djemve dhe vajzave.

Më shumë se 600,000 të rinj janë të mbuluar nga fushatat dhe aktivitetet e Klubeve "Bëhu burrë" në 120 komunitete lokale në të gjithë Ballkanin.

Bazuar në punën 14 vjeçare me të rinjtë, shkollat dhe komunitetet lokale, CARE Balkans dhe organizatat partnere kanë zhvilluar një grup rekomandimesh për përmirësimin e shëndetit të të rinjve, si dhe për zhvillimin e kapacitetit të shkollave për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të nxënësve, duke aplikuar qasje moderne pedagogjike të bazuara në prova.



Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

REKOMANDIME:

- Politikat arsimore duhet t'i bëjnë programet arsimore të bazuara në shkathhtësitë jetësore më të arritshme.
- Politikat mbi parandalimin e dhunës dhe promovimin e shëndetit duhet gjithashtu të marrin parasysh aspektet sociale që ndikojnë në qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve dhe të orientohen drejt nevojave të tyre specifike shëndetësore dhe shoqërore, të cilat korrespondojnë me rrethanat në të cilat jetojnë dhe rriten nxënësit.
- Ofrimi i qasjes më të lehtë për shkollat në programet e arsimit joformal bazuar në zhvillimin e shkathhtësive jetësore.
- Pajisja e mësuesve me certifikim për zbatimin e metodologjisë së Programit Y përmes qasjes së lehtësuar në programet e zhvillimit profesional dhe trajnimeve metodologjike.
- Politikat arsimore duhet të mundësojnë zbatimin e programeve transformuese gjinore.
- Duke akredituar Programin Y dhe mbështetjen institucionale për zbatimin e programit në shkolla, shkollat mund të inkurajohen të pranojnë metodologjinë, të sigurojnë cilësi më të lartë në zbatim, dhe stafi mësimdhënës mund të motivohet për të mbuluar më vendosmërisht të gjitha temat e përfshira në plan-programin katër vjeçar.
- Në format dhe me rezultate të integruara të të nxënësve, Programi Y është i përputhshëm me arsimin formal dhe duhet të jetë një lëndë e veçantë për shëndetin dhe mënyrat e shëndetshme të jetesës ose e integruar në orët mësimore në klasë apo përveç lëndëve të Demokracisë dhe Edukimit Qytetar.
- Krijimi i një baze institucionale për kryerjen e trajnimeve nga modeli i Programit Y për mësuesit, arsimtarët, prindërit dhe studentët dhe mbrojtja dhe mbështetja e stafin mësimor të përfshirë në zbatimin e Programit Y dhe theksimi i rolit të tyre të rëndësishëm në mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të të rinjve.
- Nëse stafi mësimdhënës nuk ndihet rehat në zbatimin e temave të caktuara, mundësoni realizimin e tyre përmes angazhimit të punëtorëve të të rinjve, pedagogëve ose edukatorëve bashkëmoshatarë.
- Krijimi i bashkëpunimit me organizatat lokale, institucionet, prindërit dhe koordinimi i aktiviteteve të shkollës paralelisht me aktivitetet në komunitetin lokal dhe mundësimi i të rinjve të sugjerojnë tema dhe aktivitete që janë plotësuese dhe mund të zbatohen brenda aktiviteteve të Klubit "Bëhu burrë".

Programi Y Përmbledhja e Politikave Nr. 1

Programi për Rritjen e Shëndetshme dhe të Sigurt të Rinisë

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Programi Y dhe aktivitetet e Klubit "Bëhu burrë" u krijuan në mënyrë të tillë që zbatimi i tyre të kërkojë një minimum të fondeve që mund të alokohen nga buxheti në dispozicion për shkollat ose komunitetet lokale. Kontributet mund të bëhen nga organizatat që ushqejnë një traditë të sipërmarrjes sociale me fokus në sektorin e biznesit që me investime minimale mund të ketë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve.

Gjeni më shumë informacione në

<https://youngmeninitiative.net> dhe <http://www.program-y.org>.

LITERATURA:

"Iniciativa e Burrave të Rinj" - Një program për të promovuar barazinë gjinore, jo dhunën dhe mënyrat e shëndetshme të jetesës, CARE International Balkans, 2018. Në dispozicion në: <https://youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2018/09/YMI_PROGRAM-Brochure-BIH.pdf>

Bëhu burrë, ndrysho rregullat!

Gjetjet dhe mësimet e marra gjatë projektit shtatë-vjeçar të Iniciativës së Burrave të Rinj të organizuar nga CARE International Balkans, CARE International Balkans, 2017. Në dispozicion në <<https://beta.youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/Nalazi-i-lekcije-nau%C4%8Dene-tokom-sedmogodi%C5%A1njeg-projekta-inicijativa-mladi%C4%87a-u-organizaciji-CARE-International-Balkan.pdf>>

„Burrat dhe djemtë si partnerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit tek të rinjtë në Ballkan”, Raporti i Vlerësimit të Linjës Fundore në dispozicion në <<http://www.careevaluations.org/evaluation/men-and-boys-as-partners-in-promoting-gender-equality-and-prevention-of-youth-extremism-and-violence-in-the-balkans/>>

Promovimi i stileve më të shëndetshme jetësore midis të rinjve në Bosnjë dhe Hercegovinë duke sfiduar stereotipet gjinore, Projekti "Iniciativa e Burrave të Rinj", Raporti i Vlerësimit të Linjës Fundore në dispozicion në <<http://www.careevaluations.org/evaluation/>

promoting-healthier-lifestyles-among-youth-in-bosnia-and-herzegovina-by-challenging-gender-stereotypes-ii-young-men-initiative-project-ii-yimi-ii/>

Programi Y (Youth) – Qasjet inovative në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe promovimin e mënyrave të shëndetshme të jetës tek djemtë dhe vajzat, CARE International Balkans, 2016, në dispozicion në: <<https://beta.youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/Program-Y-BIH.pdf>>

Edukimi rreth Shkathtësive Jetësore për Fëmijët dhe Adoleshentët në shkolla, Hyrje dhe udhëzime për të lehtësuar zhvillimin dhe zbatimin e programeve të shkathtësitë jetësore, Programi për shëndetin mendor Organizata Botërore e Shëndetësisë Gjenevë, 1997.

Edukimi rreth Shkathtësive Jetësore për Fëmijët dhe Adoleshentët në shkolla. Pjesa 1, Hyrje në shkathtësitë jetësore për kompetencën psikosociale. Pjesa 2, Udhëzime për të lehtësuar zhvillimin dhe zbatimin e programeve të shkathtësive të jetës, r. 2

Shkathtësi për shëndetin: Edukimi shëndetësor i bazuar në shkathtësi, përfshirë shkathtësitë jetësore: një përbërës i rëndësishëm i një shkolle miqësore për fëmijët/promovuese e shëndetit, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2003

Edukimi rreth Shkathtësive Jetësore për Fëmijët dhe Adoleshentët në

Shkolla. Pjesa 3, Punëtori trajnimi për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të shkathtësive jetësore, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1994.

Manual për Shkollat e Edukimit të Shkathtësive Jetësore: Parandalimi i sëmundjeve jo ngjitëse: Qasjet për shkollat, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020.

Shkathtësi për shëndetin: Edukimi shëndetësor i bazuar në shkathtësi, përfshirë shkathtësitë jetësore: Një përbërës i rëndësishëm i një shkolle miqësore për fëmijët/promovuese e shëndetit. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2003. <<https://apps.who.int/iris/handle/10665/42818>>

Manual për Shkollat e Edukimit të Shkathtësive Jetësore: Parandalimi i sëmundjeve jo ngjitëse: Qasjet për shkollat. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020. <<https://apps.who.int/iris/handle/10665/331947>>

Programi arsimor i vlerësimit global të shkathtësive jetësore, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë, New York, 2012

Rëndësia e arsimit rreth shkathtësive jetësore, Çështjet bashkëkohore në kërkimin arsimor, 2017

Edukimi rreth Shkathtësive Jetësore për të Rinjtë: Përballimi i Sfidave, Këshillimi, Psikoterapia dhe Shëndeti, Nasheeda, A. (2008).

Botues:

Zyra Qendrore CARE Gjermani e.V në BiH
CARE International Balkans
Hasana Kaimije 11, Sarajevë
www.care-balkan.org
www.youngmeninitiative.net
info@youngmeninitiative.net

**Për botuesin:**

Sumka Bučan, Drejtoreshë Regjionale

Emri i autorit:

Feđa Mehmedović

Redaktimi i tekstit:

GCDA Kosovë

Dizajni:

SMART Kolektiv Beograd

Viti i botimit dhe viti i printimit:

2020

CARE International ka përvojë mbi 25 vjeçare në implementimin e programit në rajonin e Ballkanit. Gjatë luftave dhe konflikteve të viteve të '90-ta, CARE në mbarë Ballkanin i është përgjigjur shkatërrimit, traumës, zhvendosjes dhe urrejtjes ndëretnike me punën e vet humanitare dhe jetë-shpëtuese. Nga viti 2000, CARE është përqendruar në punën zhvillimore dhe qëllimi i vet në Ballkan sot është të sigurohet se të drejtat e shoqërore, ekonomike dhe politike të grupeve të marginalizuara njihen dhe përmbushen, duke kontribuar kështu në paqe të qëndrueshme në rajon. Strategjia e programit të CARE bazohet në dy shtylla a) Përfshirja socio-ekonomike e komuniteteve dhe grupeve të marginalizuara duke kontribuar në kapacitete më të fuqishme dhe mundësi më të mira për ta, duke i shtyrë të integrohen në shoqëri dhe të kenë qasje në të drejtat e tyre. b) Barazia gjinore e grupeve të marginalizuara, duke promovuar vlerat dhe praktikën e barazisë gjinore, diversitetin dhe praktikën jo të dhunshme, duke fuqizuar kapacitetet e aktorëve për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal si dhe duke krijuar mundësi për inovacion, pjesëmarrje, mësim, bashkëpunim dhe avokim. CARE ushqen partneritetin me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë përkatëse të përkushtuara për të kontribuar për ndryshime pozitive në shoqëri.

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!
www.youngmeninitiative.net

Mbështetur nga:**Partnerët:**